REPUBLIKA E SHQIPERISË

**KUVENDI**

*Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike*

Nr._____prot. Tiranë, më ___.___.2019

<u>Lënda</u>: **Dy projektligjet e Qeverisë – kërcënim për lirinë e medias në Shqipëri si dhe kontrollin e plotë të çdo burimi informacioni në vend**

<u>Drejtuar</u>: **Z. Johannes HAHN**
**Komisioneri Europian për Politikat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit**
**Rue de la Loi, 200**
**1049 Brussels**
**Belgium**

**Z. Knut FLECKENSTEIN**
**Deputet i Parlamentit Europian**
**60 Rue Wiertz / Wiertzstraat 60**
**B-1047 Brussels**
**Belgium**

**Z. Eduard KUKAN**
**Deputet i Parlamentit Europian**
**60 Rue Wiertz / Wiertzstraat 60**
**B-1047 Brussels**
**Belgium**

<u>Për dijeni</u>: **Z. Luigi SORECA**
**Ambasador i Bashkimit Europian në Shqipëri**

*Të nderuar,*

Po ju shkruaj në lidhje me disa ndryshime ligjore të propozuara nga Qeveria shqiptare që rrezikojnë lirinë e medias dhe të drejtat politike të qytetarëve.

Ditët e fundit, Qeveria shqiptare ka paraqitur dy projektligje, që parashikojnë ndërhyrjen në Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe në Ligjin për Median Audiovizive në mënyrë që të kontrollojnë, gjobisin apo të mbyllin portalet kritike, si dhe ato që i zbulojnë aferat korruptive dhe lidhjet me bandat kriminale.

Ndryshimet e propozuara, detyrojnë të gjitha portalet e informimit të regjstrohen pranë AKEP-it, një agjensi e kontrolluar nga qeveria, pavarësisht se mund të jenë të rregjistruar në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda apo jashtë Shqipërisë. Nëpërmjet shtimit të

tërësisht nën kontrollin politik të qeverisë, i cili do të vlerësojë përmbajtjen e mediave online e do t'i propozojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare marrjen e masave për mediat online që nga gjobitja e deri në mbylljen e tyre (*ndalimin e aksesit në internet*). Është kjo arsyeja, që Qeveria po bën përpjekje të kapë edhe Bordin e AMA-s duke shkarkuar në mënyrë antiligjore një nga anëtarët përfaqësues të opozitës në të.

Pretendimi për ndërmarrjen e ndryshimeve ligjore është deklaruar të jetë nevoja për të luftuar "lajmet e rreme" dhe "shpifjet". Ligjet e propozuara zgjerojnë përkufizimin e medias online duke përfshirë edhe blogjet personale si dhe portalet e tjera të informacionit.

Projektligjet janë përgatitur në mungesë të plotë transparence, nuk janë konsultuar apo diskutuar me organizatat e mediave, gazetarët apo palë të tjera interesi. Ato u paraprinë nga një fushatë publike e Kryeministrit Rama kundër asaj çka ai e ka konsideruar "*media kazani*", "*media e rreme*" apo "*gazetari e papërgjegjshme*".

Duhet theksuar se organizatat ndërkombëtare dhe agjensitë e specializuara për mediat, në të gjitha raportet e tyre kanë evidentuar faktin që liria e medias në Shqipëri është përkeqësuar, janë rritur kërcënimet dhe dhuna ndaj gazetarëve[2].

Shoqatat shqiptare të medias[3], intelektualët, figurat publike dhe opozita kanë reaguar dhe kritikuar ashpër projektligjet e propozuara, duke i konsideruar ato një përpjekje të qartë e Qeverisë për të kontrolluar edhe mediat online, si dhe për të censuruar kritikët e saj. Këshilli Shqiptare i Medias[4], organizata më e madhe e mediave online, sheh me shqetësim të madh ndërhyrjen e drejpërdrejtë të Qeverisë në media, duke theksuar që "vetë-rregullimi" është e vetmja kornizë që siguron lirinë e medias dhe gazetarinë e përgjegjshme në Shqipëri

Katër organizata ndërkombëtare të medias[5]: Qendra Evropiane për Lirinë e Medias, Federata Evropiane e Gazetarëve, Reporterët pa Kufij dhe PEN International - i janë drejtuar kryeministrit Rama me anë të një letre duke i kërkuar të tërheqë projektligjet dhe të fillojë një diskutim të hapur me organizatat e medias për hartimin e një strategjie për të luftuar lajmet e rreme[6].

Pak kohë më parë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim[7] në Evropë denoncoi një urdhër të qeverisë për regjistrimin brenda një afati kohor prej 72 orësh të 40 portaleve on-line në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përndryshe ato rrezikonin mbylljen e tyre. Përfaqësuesi i Lirisë së Medias të OSBE-së, M. Harlem Desir, deklaroi se "shtetet nuk duhet të imponojnë regjistrimin e detyrueshëm në mediave online si parakusht për punën e tyre. Kjo mund të

---

[2] http://www.tiranaecho.com/latest-news/45-albanian-journalists-seek-to-leave-the-country-amid-threats-and-intimidation-says-the-union-of-albanian-journalists/
[3] http://kshm.al/2018/12/27/5-shoqata-te-medias-dhe-per-te-drejtat-e-njeriut-i-kerkojne-qeverise-te-terheqe-ligjet-per-mediat-online/
[4] https://politiko.al/dy-projektligjet-per-mediat-online-kshm-reagon-ndaj-ama-s-cenojne-rende-lirine-e-medias/
[5] https://www.nytimes.com/aponline/2018/12/26/world/europe/ap-eu-albania-media-laws.html
[6] https://ecpmf.eu/news/legal/albania-request-to-drop-initiative-on-amendment-of-media-laws
[7] https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/400271

ketë një ndikim shumë negativ në lirinë e medias. Një praktikë e tillë kur zbatohet, mund të kufizojë seriozisht qasjen e publikut në burime të ndryshme të informacionit, si dhe të dëmtojë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informacionit në internet".

Përkundër reagimeve të tilla, qeveria duket se synon të vazhdojë me ndryshimet legjislative duke pasur parasysh që me shumicën e siguruar të votave në Parlament mund të miratojnë edhe ligje të tilla censure.

Në cilësinë e Deputetes së Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryetares së Komisionit Parlamentar për Çështjet e Medias, i konsideroj dy projektligjet e propozuara nga Qeveria, antikushtetuese, e që cënojnë rëndë lirinë medias, lirinë e fjalës si dhe të drejtën kushtetuese për informim të qytetarëve. Dy projektligjet janë të rrezikshme për demokracinë në Shqipëri ndaj është e rëndësishme të bëjmë gjithçka për ta ndalur rënien e një tjetër muri mbrojtës të demokracisë.

Është jetike që kjo hapësirë informative të mbetet e lirë dhe e pavarur. Liria e medias duhet të jetë udhërrëfyesi kryesor në gjetjen e mekaniznave vetërregullues, që ndalojnë Qeverinë të ndërhyjë në përmbajtjen e lajmeve.

Me lejoni që me anë të kësaj letre, të kërkoj mbështetjen tuaj për t'i bërë presion Qeverisë shqiptare të tërheqë dy projektligjet e propozuara të censurës si dhe të bashkëpunojë me organizatat e medias, komunitetin e gazetarëve dhe organizatat ndërkombëtare për të gjetur rrugët e përmirësimit të cilësisë së medias, duke respektuar në të njëjtën kohë lirinë e medias dhe të shprehjes.

Me respekt,

**DEPUTETE**
**Albana VOKSHI**

Tirana, ___.___.2019

**To:** **Mr. Johannes HAHN**
**European Commissioner for European Neighbourhood Policy & Enlargement Negotiations**
**Rue de la Loi, 200**
**1049 Brussels**
**Belgium**

**Mr. Knut FLECKENSTEIN**
**Member of European Parliament**
**60 Rue Wiertz / Wiertzstraat 60**
**B-1047 Brussels**
**Belgium**

**Mr. Eduard KUKAN**
**Member of European Parliament**
**60 Rue Wiertz / Wiertzstraat 60**
**B-1047 Brussels**
**Belgium**

**Cc:** **Mr. Luigi SORECA**
**Ambassador of European Union in Albania**

**Subject:** **Two Government Draft Laws, a threat to media freedom in Albania, and danger of full control of any source of information in the country**

*Your excellency,*

I am writing to you regarding to some legislative developments in Albania, which threaten media freedom and political rights.

Albanian government has recently submitted two draft-laws, which aim to bring online media under government regulation, providing among others the compulsory government registration of all online media outlets. By providing more competencies to Audiovisual Media Authority (AMA) and Electronic and Postal Communications Authority (AKEP), government controlled institutions8. the draft laws give government the power to censure and punish media.

[8] http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-pm-accused-of-planning-online-media-censorship-12-18-2018

making efforts, in violation of the law and parliamentary procedures, to take control over the Board of AMA by firing one of the opposition's representative member in it.

The rationale behind introduction of these legal provisions has been stated to be the need to fight fake news and slender. To this end, the proposed laws extend the definition of the online media to include personal blogs and other information portals.

Such legal drafts were prepared without transparency, and were not consulted or discussed with media organizations, journalists or other stakeholders. They were preceded by a public campaign from Prime Minister Rama against what he's been labeled "trash media", "fake media" and "irresponsible journalism". At the same time, there have been increased threats and violence against journalists in Albania, which have been noted by recent international on media freedom in the country[9].

Albania's media associations[10] and public intellectuals have harshly criticized the proposed laws, considering them a clear effort by the Government to place media under its control and silence its critics. The Albanian Media Council [11], the largest online media organization, has warned government off interfering with the media, stating that "self regulation of media" is the only framework that ensures freedom of the media and responsible journalism.

Four international media organizations—the European Centre for Press and Media Freedom, the European Federation of Journalists, Reporters Without Borders and PEN International[12]—have written to Prime Minister Edi Rama urging him to drop the draft laws and start an open discussions with media organizations to come up with strategies to fight fake news[13].

Earlier in the year, Organization for Security and Cooperation in Europe[14] denounced a government's order to 40 online media outlets to register within 72 hours with the National Business Center, otherwise they'd be closed. The OSCE Media Freedom Representative, M. Harlem Desir, stated that "states should not impose mandatory registration on online media as a precondition for their work, which may have a very negative impact on media freedom. This practice, when applied, could seriously restrict public access to various sources of information, the plurality of voices, and erode the right of freedom of expression and information online."

---

[9] http://www.tiranaecho.com/latest-news/45-albanian-journalists-seek-to-leave-the-country-amid-threats-and-intimidation-says-the-union-of-albanian-journalists/

[10] http://kshm.al/2018/12/27/5-shoqata-te-medias-dhe-per-te-drejtat-e-njeriut-i-kerkojne-qeverise-te-terheqe-ligjet-per-mediat-online/

[11] https://politiko.al/dy-projektligjet-per-mediat-online-kshm-reagon-ndaj-ama-s-cenojne-rende-lirine-e-medias/

[12] https://www.nytimes.com/aponline/2018/12/26/world/europe/ap-eu-albania-media-laws.html

[13] https://ecpmf.eu/news/legal/albania-request-to-drop-initiative-on-amendment-of-media-laws

[14] https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/400271

Despite such broad reactions, government seems intent of carrying on with the legislative changes and given its outright majority in the parliament, it is all but assured that such laws will be approved.

As Member of Albanian Parliament and Chair of the Parliamentary Committee on Media Issues, I consider the two draft laws unconstitutional, with negative impact on the freedom of media, the freedom of speech and the constitutional right to inform citizens. These two draft laws are very dangerous, as freedom of media is considered a prerogative condition for opening the negotiations. It's important, to do everything to stop the collapse of another defense wall of democracy.

It is vital, the online information space remains free and independent. Media freedom should be the main guide to finding self-regulatory mechanisms that prevents the Government from intervening in the news content.

I would like to ask your support to pressure the Albanian Government to drop the proposed laws and cooperate with media organizations and journalists' community to find ways to improve the media quality, while respecting freedom of the media and expression.

Yours sincerely,

**Albana VOKSHI**
**Member of Parliament**
**Chairwoman**
**Parliamentary Committee on Media**
**The Parliament of Albania**